

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO
MUNICIPALITA LIPJAN

| | | |
|---------------|--------|---------|
| Pranuar me: | 20.09 | 20.21 |
| Primljenio: | | |
| Njesia: | Shtoja | Shtoja |
| Jednica: | B | Dodatak |
| 1-034 - 20921 | | |

Sot më 30 mars 2021 u arrit ky:

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

ndërmjet

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti Kryetar i Komunës, këtu e tutje referuar si:
Komuna

dhe

HELVETAS Swiss Interoperation Kosovo/DEMOS (HSIK/DEMOS), organizatë joqeveritare e regjistruar me numrin 5300318-4, me adresë të regjistruar në Rr. Nazim Gafurri Nr. 33, Prishtinë, 10000, Kosovë, përfaqësuar nga Z. Ertan Munoglu, Menaxher i projektit DEMOS, këtu e tutje referuar si: **HSIK/DEMOS**

1. QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit ("MM") është identifikimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive të secilës nga palët në lidhje me takimet online me qytetarë.

Në veçanti, nëpërmjet MM aktual, synohet që ndërmjet palëve të:

Arrihet marrëveshje në zhvillimin e aktivitetave për zbatimin e obligimeve ligjore të komunës për takime të rregullta me qytetarë, të cilat do të organizohen përmes platformave online.

2. HISTORIKU

Situata me pandeminë COVID-19 ka shkaktuar kufizime në funksionimin e shumë sferave të jetës, duke ndikuar kështu edhe në nivelin lokal të qeverisjes. Aktivitetet dhe takimet me qytetarë janë të kufizuara në përputhje me rinasat nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Duke u bazuar në këto kufizime, komunat nuk kanë mundësi të mbajnë takime dhe/ose aktivitete fizike.

Pjesëmarrja e qytetarëve është një parim i rëndësishëm i demokracisë lokale dhe projekti DEMOS mbështet komunat për të rritur dhe përmirsuar parimet e demokracisë lokale siç janë: përgjegjësia, transparenca, pjesëmarrja, etj. Në këtë kontekst, një përkrahje për komunat në organizimin e këtyre takimeve do të ishte më se e nevojshme.

Poashtu, komunat janë të gatshme të mbajnë takime online me qytetarë dhe të rrisin pjesëmarrjen e tyre në takime publike përkundër situatës pandemike.

3. OBLIGIMET/PËRGJEGJËSITE E PALËVE

3.1 Obligimet/Përgjegjësitë e komunës

3.1.1. Komuna ka përgjegjësi:

- a) Të sigurojë blerjen e platformës online (Zoom, Microsoft Teams apo ndonjë tjetër) e cila do të shfrytëzohet për takime me qytetarë në të ardhmen dhe në zbatim të kësaj marrëveshje;
- b) Të sigurojë planin vjetor të takimeve me qytetare;
- c) Të sigurojë që të gjitha materialet përgatiten me kohë për takimet online;
- d) Të identifikojë grupet specifike të interesit të cilat do të jenë të targetuara për takime të caktuara;
- e) Për zbatimin e kësaj marrëveshje, Komuna duhet që përmes Zyrtarit/es të informimit (ZI) të respektoj afatin ligjor dhe publikojë njoftimin ne:
 - I. Ueb faqen komunale;
 - II. FB zyrtar të komunës;
 - III. Rrjete të tjera (nëse ka komuna në dispozicion, si p.sh. radio lokale);
 - IV. Ripublikojë linkun dhe njoftimin në rrjete sociale, më së lartë 7 ditë para takimit dhe ripostojë një ditë para takimit;
- f) ZI dhe Zyrtari/ja për Barazi Gjinore (ZBGJ) si dhe drejtoria përgjegjëse për takimin specifik të identifikojë grupin e synuar për takim dhe të aktivizojë dhe inkurajojë ata për pjesëmarrje më të madhe përmes ftesave, thirrjeve dhe diskutimeve me ta në grupe të caktuara;
- g) ZI përgatitë një listë të organizatave jo qeveritare lokale (OJQ-të), këshillat e fshatit, grupet e interesit dhe dërgon ftesën përmes emailit te këta pjesëmarrës relevant për takimin përkatës;
- h) ZBGJ fton grupet e grave (OJQ, grupe rinore etj), asambleistet - grupin joformal të grave;
- i) Prezantuesi/ja (kryetari, kryesuesi i Kuvendit komunal, drejtori, apo ndonjë zyrtar tjetër komunal) siguron që takimi të jetë i strukturuar mirë, të përgatisë një prezantim të shkurtë dhe të thjeshtë për pjesëmarrësit dhe të ndihmohet nga ZI dhe zyrtari i teknologjisë informative (ZTI).

3.1.2 Për mbarëvajtjen e takimeve online komuna duhet të sigurojë që para takimit:

- a) ZI, ZTI, ZBGJ të kyqen në takim gjysmë ore para takimit;
- b) ZTI të marr rolin e menaxhimit të takimit;
- c) ZI të mbajë evidencë për numrin e qytetarëve në takim (përmes fotove apo mënyrave tjera të dokumentimit);
- d) ZI dhe ZTI sigurojnë transmetimin online të takimit.

3.1.3 Pas takimit online me qytetarë komuna duhet të sigurojë që:

- a) Raporti nga takimi përfshin trajtimin e kërkesave/pyetjeve të qytetarëve;
- b) Publikimin e raportit në ueb faqe dhe facebook-un zyrtar (FB) më së lartë 7-15 ditë pas takimit;
- c) Përcjelljen e raportit dhe kërkesave të qytetarëve në kuvendin komunal apo organe tjera relevante të komunës.

3.2 Obligimet/Përgjegjësitë e HSIK/DEMOS

- a) Të këshillojë dhe ofrojë trajnime për stafin përgjegjës të komunës për procedurat, organizimin dhe mbarëvajtjen e takimit;
- b) Të mbajë takim me zyrtarët nërgjegjës (ZI, ZBGJ, ZTI) për takimet online;

- c) Të sigurojë se materialet janë të kompletuara dhe adekuate (të thjeshtuara) për prezantim para qytetarëve;
- d) Të gjenerojë dhe dërgojë linkun e takimit te Zlose personi përgjegjës për takim;
- e) Të hap linkun 30 min para takimit dhe së bashku me ZTI dhe ZI i përsërisin gjërat edhe njëherë për menaxhimin e takimit;
- f) Të dërgojë linkun te zyrtari kontaktues, nëse takimi është inqizuar;
- g) Të monitorojë respektimin e detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarëve komunal dhe dërgojë një email te kryetari për përbashjen apo mospermashjen e këtyre detyrave, duke përfshirë:
 - I. Sigurimin e hartimit të raportit të konsultimeve perfshirë trajtimin e kërkesave të qytetarëve dhe publikimin e raportit ne ueb faqe dhe FB zyrtar të komunës, më së largu 7-15 ditë pas takimit;
 - II. Përcjelljen e kërkesave në Kuvend Komunal apo organe tjera relevante komunale.

4. KOORDINIMI DHE KONSULTIMI

Palët do t'i ofrojnë njëra tjetrës informacionet e nevojshme për të ndihmuar në zbatimin me sukses të kësaj iniciative. Palët gjithashtu do të takohen në baza periodike për të shqyrtaar dhe koordinuar dhe për t'i shkëmbyer informacionet relevante. Çështjet në lidhje me interpretimin, administrimin apo zbatimin e këtij MM zgjidhen me konsultim ndërmjet palëve.

5. SHQYRTIMET TJERA

Palët në këtë MM zotohen për bashkëpunim për të arritur shkallë të lartë të suksesit gjatë zbatimit të projektit. Palët zotohen për zgjidhje nëpërmjet MM të ndërsjellë të të gjitha çështjeve që dalin gjatë projektit dhe për të cilat nuk janë përshkruar zgjidhje në këtë MM.

6. FILLIMI, NDRYSHIMI DHE PËRFUNDIMI

Ky MM do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet në fuqi deri më 30 nëntor 2021. Për cfarëdo ndryshimi të këtij MM, palët duhet të njoftojnë njëra tjetrën së paku 15 ditë më heret. Cdo ndryshim i këtij MM duhet të nënshkruhet nga të dyja palët dhe të bashkangjitet si aneks i këtij MM. Cilado nga palët mund ta ndërpresë vlefshmérinë e këtij MM duke e njoftuar me shkrim 15 ditë më heret palën tjetër.

7. MARRËDHËNIA JURIDIKE

Ky MM përpilohet si deklaratë e qëllimit për të promovuar një bashkëpunim të mirëfilltë dhe me përfitim të ndërsjellë ndërmjet palëve. Asnjë pjesë e këtij MM nuk krijon marrëdhënie juridike ndërmjet palëve.

8. PËRGJEGJËSIA

Përveç humbjeve apo dëmëve të shkaktuara nga neglizhencë e madhe apo me qëllim, palët nuk mbajnë përgjegjësi ndaj njëra tjetrës sipas kushteve të këtij memorandumi.

9. KONFIDENCIALITETI

Palët e pranojnë që me qëllim të lidhjes së këtij MM, ato, herë pas here, mund të kenë qasje në informacione konfidenciale në llichje me operacionet e njëra tjetrës pasi që ndërlidhen me projektin. Të dyja palët pajtohen që nuk do t'i shpalosin informacionet konfidenciale dhe/ose materiale pa pëlqimin e palës tjetër dhe përvèç nëse shpalosja e tillë autorizohet me këtë MM apo kërkohet me lergjislacionin në fuqi. Përvèç kësaj, informacionet konfidenciale të kualifikuara të palës do të trajtohen me gjykimin dhe diskrecionin maksimal.

10. MOSDISKRIMINIMI

Nuk do të ketë diskriminim të stafit të palëve në bazë të racës, ngjyrës, besimit, religionit, gjinisë, statusit martesor, orientimit seksual, moshës, paaftësisë fizike, prejardhjes apo origjinës kombëtare në disponueshmérinë dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse.

11. VLEFSHMËRIA E PJESSHME

Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj marrëveshje identifikohet si e pavlefshme, joligjore apo e pazbatueshme në çfarëdo aspekti, kjo pavlefshmëri, joligshmëri apo pazbatueshmëri nuk do të prekë vlefshmërinë, ligjshmërinë dhe zbatueshmërinë e dispozitave tjera të marrëveshjes.

12. CERTIFIKIMI I AUTORITETIT PËR NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES

Zyrtarët që nënshkruajnë këtë MM për dhe në emër të palëve nëpërmjet kësaj vërtetojnë nëpërmjet nënshkrimeve se janë të autorizuar në mënyrë të rregullt për nënshkrimin e këtij MM.


Ky MM është hartuar në dy (2) kopje identike, një (1) në gjuhën angleze dhe një (1) në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën Palë.

PËR: Komunën



Imri Ajeti

PËR: HSIK/DEMONS



Ertan Muroglu